



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:123293
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05799122
C.nr. 1965/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, në çështjen kontestimore të paditësit M.S nga Gjilani, Rruga „...” nr..., të cilin e përfaqëson me autorizim Bashkim Ilijazi nga Gjilani, kundër të paditurve Xh.S dhe N.D, që të dy nga Gjilani, tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Rrustem Latifaj, avokat nga Gjilani, me objekt kontesti, vërtetimi i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 5000.00€, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 05.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit M.S nga Gjilani e ushtruar kundër të paditurëve Xh.S dhe N.D, që të dy nga Gjilani, tani me adresë të panjohur, me të cilën paditësi ka kërkuar që të vërtetohet ndaj të paditurve se paditësi në bazë të shitblerjes, është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale P-70403013-01643-22 në sipërfaqe prej 612m², ZK. Gjilan, e cila gjendet në vendin e quajtur “Zabeli i Sahit Agës”, në përmasa dhe kufij: Në pjesën lindore, perëndimore dhe jugore kufizohet me pjesën e parcelës numër 1643-22, në 10 thyerje, thyerja e parë në gjatësi prej 4 metra, thyerja e dytë në gjatësi prej 4.74 metra, thyerja e tretë në gjatësi prej 17.14 metra, thyerja e katërt në gjatësi prej 21.64 metra, thyerja e pestë në gjatësi prej 3.96 metra, thyerja e gjashtë në gjatësi prej 11.59 metra, thyerja e shtatë në gjatësi prej 5.06 metra, thyerja e tetë në gjatësi prej 3.84 metra, thyerja e nëntë në gjatësi prej 11.91 metra dhe thyerja e dhjetë në gjatësi prej 13.89 metra, në pjesën veriore kufizohet me parcelën numër 1643-11, në 3 thyerje, thyerja e parë në gjatësi prej 4.83 metra, thyerja e dytë në gjatësi prej 10.71 metra dhe thyerja e tretë në gjatësi prej 23.44 metra, ngastër kjo e cila sipas certifikatës pronësore me numër të lëndës 24744-2024 evidentohet në emër të bashkëpronarëve Xh.S dhe N.D, me nga ½ e pjesës ideale si dhe të detyrohet DGJKP në Gjilan, që në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm, të bëjë ndryshimet në regjistrin kadastral.

II. Detyrohet paditësi, që përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurve, avokatit Rrustem Latifaj nga Gjilani, t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 644.00 euro, në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M.S nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të tij Bashkim Ilijazi nga Gjilani, në padinë e ushtruar në këtë gjykatë dhe me rregullimin e kërkesëapdisë si në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.06.2024, ka kërkuar që të vërtetohet ndaj të paditurëve Xh.S dhe N.D, se paditësi në bazë të shitblerjes, është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale numër 1643-22, ZK Gjilan, në

sipërfaqe prej 612 m², e cila gjendet në vendin e quajtur “Zabeli i Sahit Agës”, në përmasa dhe kufij: Në pjesën lindore, perëndimore dhe jugore kufizohet me pjesën e parcelës numër 1643-22, në 10 thyerje, thyerja e parë në gjatësi prej 4 metra, thyerja e dytë në gjatësi prej 4.74 metra, thyerja e tretë në gjatësi prej 17.14 metra, thyerja e katërt në gjatësi prej 21.64 metra, thyerja e pestë në gjatësi prej 3.96 metra, thyerja e gjashtë në gjatësi prej 11.59 metra, thyerja e shtatë në gjatësi prej 5.06 metra, thyerja e tetë në gjatësi prej 3.84 metra, thyerja e nëntë në gjatësi prej 11.91 metra dhe thyerja e dhjetë në gjatësi prej 13.89 metra, në pjesën veriore kufizohet me parcelën numër 1643-11, në 3 thyerje, thyerja e parë në gjatësi prej 4.83 metra, thyerja e dytë në gjatësi prej 10.71 metra dhe thyerja e tretë në gjatësi prej 23.44 metra, ngastër kjo e cila sipas certifikatës pronësore me numër të lëndës 24744-2024 evidentohet në emër të bashkëpronarëve Xh.S dhe N.D, me nga ½ e pjesës ideale si dhe të detyrohet DGJKP në Gjilan, që në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm, të bëjë ndryshimet në regjistrin kadastral.

Padisi në pretendimet tij si në padi dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka theksuar se në vitin 1991, ka blerë pjesën e parcelës P-70403013-01643-22, në sipërfaqe prej 612m² nga të paditurit Xh.S dhe N.D, që të dy atëherë nga Gjilani, me qmimin e përgjithshëm prej 250000.00 dinarë të atëhershëm jugosllav dhe se në tërësi ka përmbushur detyrimet që dalin nga marrveshja gojore dhe që atëherë e deri më tani paditësi e shfrytëzon këtë pjesë të parcelës i papenguar nga askush, ku në të njëjtën ka të ndërtuar shtëpi banimi në të cilën jeton me anëtarët e familjes së tij. Për provë të pretendimeve të tij gjykatës i ka propozuar që të administroj: Certifikatën pronësore me numër të lëndës 24744-2024, Vendimi mbi caktimin e tatimit në pasuri, regjistruar në emër të I.I, lëshuar nga Drejtoria Republikane e të Hyrave Publike – Njësia Rajonale në Gjilan për vitin 1994; Vendimi i lëshuar nga ish-Komuna e Gjilanit, me numër 30031, i dt. 01.01.1994; Fatura e energjisë elektrike, sipas shifrës së njehsorit elektrik me numër 643480, e dt. 08.08.1996; Fatura tjetër e energjisë elektrike, e dt. 30.09.1996, në emër të I.I Konstatimi nga matjet gjeodezike, përpiluar nga ana e ekspertit gjeodet V.A, pranuar në këtë gjykatë më dt. 18.04.2024, shikimin e gjykatës në vendin e ngjarjes dhe dëgjimin e dëshmitarve R.I nga fshati ..., K. e Preshevës dhe dëshmitarit F.SH nga fshati ..., K. e Gjilanit.

Lidhur me këtë qështje, gjykata me Aktvendimin C.nr.1965/2020, të datës 29.01.2024, të paditurve Xh.S dhe N.D, gjykata i'a ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm avokatin Rustem Latifaj nga Gjilani, për shkak të mungesës së adresës së vendbanimit apo vendqëndrimit të tyre, konform dispozitave ligjore nga neni 79 i LPK-së.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, avokati Rustem Latifaj, përmes përgjigjes në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në prova dhe fakte nga vet fakti se dëshmitarët e dëgjuar R.I dhe F.SH, kanë deklaruar se kjo pjesë e parcelës është blerë në vitin 1991, nga I.S–babai i paditësit M.S, i cili ka lënë si trashigimtarë tre /3/ djemë, meqë ka vdekur aty kah viti 2011-2012, andaj paditësit si të vetëm i mungon legjitimitetit real aktiv në këtë qështje kontestimore.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, ngase paditësit si trashigimtarë ligjor i rendit të parë të trashigimisë i mungon legjitimitetit real aktiv si i vetëm me qenë palë në këtë kontest, meqë pos tij i ndjeri I.I-babai i paditësit, ka lënë bashkëshorten e tij S.I, ku paditësi e ka tërhequr padinë e saj dhe dy djemë tjerë të cilët duhet të jenë palë në këtë kontest, meqë në mes të trashigimtarve ligjor krijohet

bashkëndërgjyqësia unike e përcaktuar në nenin 269 të LPK-së, ashtu që në këtë kontekst legjitimitetit real në shkencën juridike civile nënkuptohet raporti subjektiv i paditësit dhe të paditurit ndaj të drejtës subjektive për mbrojtjen e së ciles është vënë në veprim procesi kontestimor. Për palën ndërgjyqëse thuhet se është e legjitimuar realisht në qoftëse është pjesëmarrëse në raportin materialo-juridik nga i cili ka lindur kontesti. Paditësi ka legjitimitetin aktiv në qoftëse në raportin materialo-juridik e ka rolin e kreditorit, kurse i padituri e ka legjitimitetin pasiv, në rast se në raportin materialo-juridik e ka rolin e debitorit. Lidhur me legjitimitetin real esenciale është pyetja: a mund një person si paditës ta paraqes si të themeltë kërkesëpadinë e personit tjetër si të paditur? Kjo pyetje si shifet është e natyres thjesht materialo-juridike e jo e natyres proceduralo-juridike, prandaj, në rast të mungesës të legjitimitetit qoft të atij aktiv apo pasiv kërkesëpadia duhet të refuzohet me aktgjykim (si vendim meritor) për shkak të pa themelsisë, e nuk mund të hudhet posht padia si e palejueshme me aktvendim (si vendim procedural). Në rastin konkret paditësi M.S nuk është në raport materialo juridik dhe nuk e ka cilësinë e kreditorit nga ky raport si i vetëm, duke anashkaluar bashkëshorten e të ndjerit I.I dhe dy fëmijët tjerë të të ndjerit, të cilët duhet të jenë palë në procedurë qoftë në aspektin aktiv apo pasiv së bashku me të paditurit tjerë.

Këto fakte gjykata i ka vërtetuar me dëgjimin e dëshmitarve R.I nga fshati ..., K. e Preshevës, i cili ka deklaruar në mes tjerash se ... *Vëllai im I.S në vitin 1991 e ka blerë një sipërfaqe të tokës për afro 6 ari, nga personat me emrat S dhe D, në shumën e përgjithshme prej 18000.00 DM... Ne jemi 4 vëllezër, edhe atë Q.II.I, XH.I dhe unë R.I, kurse M.S është djali i I.It-tani i ndjerë. Deklaroj se bartja e pronësisë në emër të blerësit nuk është bërë për shkak se në atë kohë ka qenë e ndaluar bartja e pronësisë. Po ashtu, deklaroj se me rastin e shitblerjes prezent kemi qenë unë dhe I-vëllai im, i cili këtë paluajtshmëri e ka blerë për vete. Kurse dëshmitarit tjetër F.SH nga fshati Llovcë, K. e Gjilanit, i cili mes tjerash ka deklaruar se „ Ne që nga paraluftra jetojmë në Gjilan, në lagjen “Qenar Çeshme”. Nuk e di saktë vitin kur është blerë kjo pjesë e parcelës, të cilën e kishte blerë babai i M.St, I.I. Deklaroj se në kohën kur është blerë kjo parcelë unë kam qenë i vogël dhe nuk i di rrethanat dhe faktet, por e di që I.I-babai i paditësit M.S ka vdekur aty kah viti 2011-2012, saktësisht nuk e di dhe i njëjti ka lënë 3 djem. Nuk e di nëse Isaku sa ka qenë gjallë ia ka ndarë pasurinë djemve të tij. Andaj, në përmbajtje të deklaratave të dëshmitarëve, vërtetohet se paditësi M.S nuk është trashigimtarë i vetëm ligjor i të ndjerit I.I, pori ndjeri ka lënë pas vdekjes edhe bashkëshorten S.I dhe tre djemë, në mesin e të cilëve është edhe paditësi M.S dhe se në parashtrësë-padi nuk janë përfshirë të gjithë trashigimtarët ligjor si bashkëndërgjyqës unik, prandaj, paditësi M.S si i vetëm nuk mund të ndjek qështjen në gjyq, për shkak të mungesës së legjitimitetit real të tij.*

Nga këto arsye gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë duke marr aktgjykim meritor, meqë mungesa e legjitimitetit real është prezumim materialo juridik dhe kërkespadia duhet të vendoset me vendim meritor.

Gjykata ka administruar provat tjera materiale, por që ato nuk arsyetohen nga gjykata, për shkak të arsyeve të cekuara më lart.

Gjykata, vendosi që paditësi t'i bartë shpenzimet e procesit kontestimor edhe ate shumen prej 644.00€, për shpërblimin e punës së përfaqësuesit të përkohshëm, konform nenit 452.1 dhe 452.4 të LPKsë, lartësia e tyre është caktuar konform TOAK-së edhe ate për 4 përfaqësime gjyqësore nga 1350.00€, për qdo përfaqësim si dhe 104€ për përgjegje në padi.

Nga të cekurat si më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:123293
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05799122

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:123293, 05.06.2024

G j y q t a r i
Berat Spahiu

UDHËZIM JURIDIK - Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.